

KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT ZNJ. MANJOLA KUME



Orari i Shërbimit: E Hënë – E Premte Ora 08:00 – 16:00



Adresa: Lagjja “5 Maj” Rruga “Koço Brisku” Elbasan, Shqipëri.



Telefon: 00355 (54) 25 99 51



E-mail: manjola.kume@gjykata.gov.al

KËRKESAT PËR INFORMACION

I nderuar kërkuar,

Ju mund t'i drejtoni kërkesat tuaja nëpërmjet adresës së e-mail manjola.kume@gjykata.gov.al duke plotësuar [formularin e kërkesës i cili gjendet këtu](#), ose direct me kërkesë në e-mail.

Pas plotësimit, kërkesa dërgohet në adresën e postës elektronike të gjykatës: manjola.kume@gjykata.gov.al

Ju mund të dërgoni kërkesën tuaj për informacion edhe nëpërmjet plotësimit të (FEA) [Formulari Elektronik i Aplikimit i cili gjendet këtu](#)

Ju informojmë se çdo kërkesë për informacion duhet të ketë bashkëlidhur këto dokumente:

A. Për individët

1. Mjet identifikimi (kartë identiteti, pasaportë).

B. Për palët në proces gjyqësor

1. Mjet identifikimi (kartë identiteti, pasaportë, karta avokatit).
2. Prokurë përfaqësimi të palës në proces gjyqësor.

C. Për mediat

1. Met identifikimi (kartë identiteti, pasaportë).
2. Kartën e përfaqësimit të institucionit ose autorizimin e nënshkruar të medias për të cilën kërkohet informacioni.
3. Në Vendim Nr. 716, datë 06.12.2023 “Udhëzues Standard të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median”, i miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor neni 12/3 përcakton: Aksesi në dosjet gjyqësore: Në çdo rast, personi që kërkon akses është i detyruar të ruajë konfidencialitetin e informacionit duke nënshkruar deklaratën përkatëse (**Deklaratë Konfidencialiteti**), e cila plotësohet dhe dërgohet e skanuar me nënshkrimin e kërkuar. [Deklaratën e Konfidencialitetit e gjeni në lidhjen këtu](#).

4. Përfaqësuesit e medias të cilët kërkojnë regjistrim/trasmetim të seancave gjyqësore duhet të plotësojnë “Formular për Përfaqësuesit e Medias, Kërkesë për Regjistrimin/Trasmetimin e Imazheve Filmike të Seancës Gjyqësore” të cilën e gjeni këtu.
5. Njihu me përmbajtjen e me Vendim Nr. 716, datë 06.12.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Udhëzues Standard të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median” e gjeni të publikuar më 21.12.2023 në lidhjen këtu.
6. Vendim Nr. 716, datë 06.12.2023 *“Udhëzues Standard të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median”* Neni 8/2 përcakton: *“Publikimi i informacionit pa kërkesë bëhet nga gjykata, duke vlerësuar interesin dhe të drejtat e publikut për t’u informuar mbi veprimtarinë e gjykatës.”*. Këto informacione publikohen në rubrikat e faqes zyrtare të gjykatës www.gjykata.gov.al.
7. Në Vendim Nr. 716, datë 06.12.2023 *“Udhëzues Standard të Marrëdhënieve të Gjykatave me Publikun dhe Median”* Neni 9 përcakton se: *“Të dhënat pa kërkesë 1. Të dhënat që vihen në dispozicion pa kërkesë përfshijnë informacione apo dokumente të cilat nuk ndalohen me ligj të bëhen publike.”*.
8. Informacioni i bërë publik nuk kërkon plotësim kërkesë dhe identifikim të subjekteve.
9. Ju informojmë se, për shkak të konfidencialitetit që përmbajnë aktet dhe informacionet për çështjet gjyqësore, do të refuzohen kërkesat e subjekteve që nuk plotësojnë kriteret për identifikim për kërkesat për informacion, dokumente apo akte të cilat nuk janë publike dhe kërkojnë në bazë të plotësimit të një kërkesë.

Miratoi

ZV/KRYETAR
Z. ELIS DINE

GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN

